



## Momente historike

# TRE MEDALJET E NËNË TEREZËS

Tre medalje: kjo është "trashëgimia" e lënë nga Nënë Tereza për ndërtimin e spitalit "Zoja e Këshillit të Mirë". Ishte një gjest i thjeshtë i pjesëmarrjes shpirtërore në një projekt që kërkonte një investim të madh.

Me këtë donacion të çmuar shenjtorja shqiptare u angazhua personalisht për ndërtimin e spitalit që e donte aq shumë, duke marrë pëlqimin e plotë të Kishës Katolike dhe Qeverisë kombëtare.

Tani që Spitali është në funksion nuk mund ta harrojmë nismën e saj të mbushur plot dashuri. Mbi tridhjetë vjet më vonë jemi dëshmitarë të një "mrekullie" që vazhdon.



At Binu Peediyecal Devassia, drejtor administrativ i Universitetit

## TË VEPROSH ME KONCEPTIN "GLOCAL"



Realiteti i kohës sonë kërkon që ne të veprojmë me vizionin e një bote të hapur dhe gjithëpërfshirëse, të ndriçuar nga teoritë dhe përvojat e shumta. Megjithatë, nuk duhet të humbasim aftësinë për të kombinuar konceptin lokal me atë global ("glocal"). Bëhet fjalë për një koncept as të dukshëm dhe as të menjëhershëm. Universiteti ZKM, i angazhuar prej njëzet vitesh për t'iu përgjigjur nevojave arsimore të Shqipërisë i kthen gjithnjë e më shumë sytë nga e gjithë bota dhe për këtë arsye i ka besuar At Binu detyrën e administratorit të Universitetit, të cilën e nje nga afër pas tre vitesh prezencë të qëndrueshme në Kompleksin universitar dhe spitalor ZKM në Tiranë.

Me origjinë indiane dhe 45 vjeç, ai ka kryer studime filozofike dhe teologjike dhe ka marrë kualifikime akademike dhe profesionale në fushën arsimore, psikologjike dhe administrative për menaxhimin e kujdesit shëndetësor, burimeve njerëzore dhe administrimit të biznesit. Ai flet të katërta gjuhët e shteteve indiane, si dhe anglisht dhe italisht. Përmes këtyre faqeve shprehim falënderimet tona për Znj. Evis Karandrea që e mbajti këtë rol gjatë gjashtë viteve të fundit dhe i shprehim urimet tona më të përzemërta At Binu për detyrën e tij të re.

# NJË UDHËTIM NGA VITI 1993 ... DERI MË SOT

Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë" mbushi 31 vjeç! Ky është një moment kulmor dhe gur kilometrik për aktivitetin bamirës të këtij enti juridik që u themelua në Shqipëri në vitin 1993.

Fondacioni përfaqëson në Shqipëri qëllimin dhe frymëzimin e karizmës ungjillore të fetarit italian **Luigji Maria Monti** (*Bovisio Masciago 1825–Saronno 1900*), infermier dhe edukator.

Fondacioni ka dy fusha veprimi dhe si prioritete të tij ka

zhvillimin në Shqipëri, shërimin e të sëmurëve nëpërmjet kërkimit shkencor, kujdesin dhe mikpritjen ndaj të rinjve duke u siguruar atyre formimin e duhur për jetën.

Kampusi Universitar Zoja e Këshillit të Mirë brenda të cilit është ndërtuar Universiteti dhe Spitali Katolik është sot padyshim kënd graviteti për kërkimin shkencor, për kujdesin ndaj shëndetit, për standardet në arsim dhe rritje profesionale të të rinjve.



1993

2024

Me mbështetjen e Fondacionit kampusi universitar dhe spitalor janë kthyer në pika reference për qindra familje të Bashkimit Evropian dhe të Shqipërisë që prej 20 vitesh na besojnë arsimimin e fëmijëve të tyre.

Në Shqipëri udhëheqim me cilësi dhe diploma të pakonkurueshme, të cilat njihen në BE dhe më gjerë. Mbi 90% e të diplomuarve tanë gjejnë menjëherë punë në Shqipëri dhe vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, duke na renditur në vendin e meritës për cilësinë pa kompromis të mësimdhënies dhe mentorimit të karrierës. Në kampus organizohen gjatë vitit akademik konferenca

të shumta shkencore dhe shëndetësore, të cilat përfshijnë kontributet e profesorëve të njohur dhe të të ftuarve që kanë reputacion të lartë profesional në vende të BE-së.

Universiteti ynë ka marrë me sukses Kartën Erasmus për Arsimin e Lartë, akreditim ky i dhënë nga Komisioni Evropian për periudhën 2021-2027 për Institucionet e Arsimit të Lartë që janë të kualifikuara për të marrë pjesë në shkëmbimet dhe bashkëpunimet evropiane dhe ndërkombëtare në kuadër të programit Erasmus+ (Programi evropian i Arsimit, Trajnimit, Rinisë dhe Sportit).

Spitali Katolik gjithashtu ofron shërbime të shumta shëndetësore të një niveli të lartë bashkëkohor, nga trajtimet dhe konsultat për sëmundje të brendshme, kirurgjitë e ndryshme deri tek spitali ditor. Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë mbështet misionin e përkujdesjes dhe trajtimit modern për pacientët, nëpërmjet integritimit në një sistem të vetëm të nivelit më të lartë shkencor dhe teknologjik, duke ruajtur parimet e humanizmit.



## RISITË DHE KONFIRMIMET

**M**e propozim të rektorit prof. Leonardo Palombi, Këshilli i Administrimit të Universitetit emëroi dekanët e Fakulteteve si më poshtë:



**Prof. GUIDO MACCHIARELLI**  
Fakulteti i Mjekësisë  
dhe Kirurgjisë



**Prof. ROBERTO PERRONE**  
Fakultetin i Farmacisë



**Prof. FABIO CAPANNI**  
Fakulteti i Shkencave  
të aplikuar/Arkitekturë



**Prof. VITTORIO TEOTONICO**  
Fakulteti i Ekonomisë

I urojmë punë të mbarë nga ana jonë.

International Center for Nursing Research

## LIND “MONTIANUM”

**N**ë këtë dyqindvjetor të lindjes së të Lumit Luigji Monti, Universiteti ZKM ka promovuar një Qendër kushtuar studimeve dhe kërkimit në fushën e infermierisë. Referenca për Montin nuk është e rastësishme, pasi ai ka qenë themeluesi i një komuniteti njerëzish të shenjtëruar dedikuar kujdesit ndaj të sëmurëve në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur figura profesionale e infermierit nuk ekzistonte ende. Qendra “Montianum” synon të promovojë ekselencën në kërkimin infermieristik për të përmirësuar shëndetin, sigurinë e pacientëve dhe mirëqenien e popullatës.

Objektiv tjetër është gjithashtu tërheqja e talenteve dhe promovimi i bashkëpunimit ndërdisiplinor në nivel ndërkombëtar. Qendra drejtohet nga prof. Gennaro Rocco, pedagog prej shumë kohësh në Universitetin tonë.



Gjithmonë mund të thuhet po ose jo



## KOPSHTI I TË DREJTËVE KA BËRË JEHONË!

**K**opshti i të Drejtëve në Kampusin Universitar Zoja e Këshillit të Mirë tashmë ka bërë jehonë dhe është publik në listën e hartave në seksionin “Kopshtet”.  
<https://it.gariwo.net/giardini/giardino-di-tirana>


## INOVACIONI NË SPITALIN KATOLIK NË SHËRBIM TË SHËNDETIT



Këtë vit në UKZKM çelet specializimi afatgjatë në programin e studimit mjekësi, në fushën e kirurgjisë maksilofaciale. Ky profil kirurgjie i një shkalle delikate merret me trajtimin e problematikave kirurgjikale të kokës, dhe qafës. Ky specializim lindi si nevojë disa dekada më parë kur bota përfshihej lehtësisht në konflikte të përgjakshme luftërash, gjatë të cilave pasojat në njerëz ishin të shumta. Ndaj traumatologjia është një nga shtyllat kryesore të kësaj kirurgjie. Kirurgjia maksilofaciale është e para që në UKZKM do të mësohet dhe aplikohet sipas modeleve evropiane. Kurrikulat mësimore që plotësojnë sfondin e këtij specializimi do të përshtaten nga mjekësia e përgjithshme. Kjo kirurgji kryen rikonstruksionin e defekteve të lindura, sindromave të zhvillimit apo kongenitale, apo të fituara si pasojë e sëmundjeve tumorale, si edhe dëmtimeve që shkaktojnë traumat madhore.

Ky specialitet trajton patologji onkologjike të kokës, qafës përfshirë edhe patologji si kanceri i lëkurës së fytyrës, kancer i kavitetit oral, nazo-faringut, oro-faringut dhe njëkohësisht rikonstruksion të këtyre defekteve pas ndërhyrjeve.

Rikonstruksioni bazohet në transferimin e indeve të lëkurës apo organeve nga pjesë të tjera të trupit që mund të jenë në afërsi apo distancë të zonës së sëmurë. Kirurgjia maksilofaciale kërkon gjithashtu zotërimin e mirë dhe të plotë të teknikave mikrovaskulare që po aplikohen me sukses edhe në ndërhyrjet e fundit kirurgjikale pranë Spitalit Katolik. Fushë e rëndësishme e këtij specialiteti është edhe kirurgjia palstike, e cila trajton problematikat e plakjes së fytyrës dhe teknikat regjenerative të zonave të caktuara të saj.



Një degë tjetër e kirurgjisë maksilofaciale është edhe trajtimi i problematikave që vijnë nga strukturat dentare të kavitetit oral.

Ky specializim zgjat 5 vjet dhe është i bashkëngjitur me Departamentin e Kirurgjisë në Spitalin Katolik brenda Kampusit Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" ku zbatohen të gjitha standardet dhe metodat moderne të vendeve të Bashkimit Evropian.

Nisja e këtij programi specializimi është një përpjekje madhore për të krijuar brezin e ri të mjekëve që do të specializohen në këtë kirurgji të vështirë, por shumë të kërkuar kudo në botë për shkak të evolucionit njerëzor. Lektorë dhe profesorë të njohur në vendet e BE-së, të cilët kanë rezultate mbresëlënëse në këtë fushë do të jenë pjesë e dhënies dhe praktikës së kurrikulës mësimore. Disa ditë më parë në Spitalin Katolik u krye me sukses një ndërhyrje e vështirë kirurgjikale tek një pacient që kishte masë tumorale në gjuhë. Pas dhjetë orësh në sallën e operimit mjekët e Spitalit Katolik ia dolën të hiqnin plotësisht një masë tumorale në organin e gjuhës përfshirë edhe satelitët e saj në qafën e pacientit.

Kjo histori suksesi në Spitalin Katolik u shërben lehtësisht edhe studentëve të mjekësisë, të cilët gjatë studimeve brenda Kampusit Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" kanë mundësi të fitojnë praktikën mësimore dhe profesionale në mentorimin e mjekëve tanë.

# SHKODRA E FIERI NË SYTË E ARKITEKTËVE TË DIPLOMUAR NË UKZKM

Arkitektura është qytetërim dhe sa më shumë të rinj zgjedhin këtë program studimi në UKZKM, aq më shumë shpresë ka se në Shqipëri po lind një epokë e re zhvillimi urban. Provë e këtyre përpjekjeve janë diplomimet në Universitetin Katolik, gjatë të cilave studentët sjellin projekte të mirëmenduara profesionalisht që propozojnë cilësi të re të peisazhit arkitekturor në vend. Pak ditë më pare në sallën "Magna" pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dy prej studentëve tanë të Arkitekturës paraqitën tezat e diplomës. Projektet e studentëve lidheshin me qytetet e tyre të lindjes, Shkodrën dhe Fierin.



Studentja e arkitekturës **Klaudiana Kimça** paraqiti projektimin e një porte të re hyrëse për qytetin e Shkodrës që ndërthur historinë dhe trashëgiminë e qytetit me nevojat për zhvillim urban të qëndrueshëm dhe modern. Shkodra e të ardhmes u paraqit para profesorëve, familjarëve e miqve të Klaudianës që ndoqën paraqitjen e këtij projekti ambicioz, i cili është rezultat i një programi studimi të niveleve ndërkombëtare që kryhet në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".




Tema tjetër e diplomës u paraqit nga student **Juard Myftaraj**, i cili prezantoi projektin për Stacionin Hekurudhor të qytetit të tij të lindjes, Fierit.



Duke shpjeguar sintetikisht para profesorëve historinë dhe trashëgiminë urbane të Fierit, projekti për stacionin hekurudhor mbante në konsideratë volumet e ndërtimit arkitekturor që sjellin në kohë të reja shërbimin e transportit publik, duke respektuar mjedisin, hapësirat e gjelbërta dhe zhvillimin urban të qytetit.

Ju urojmë suksese të diplomuarve tanë të rinj! Ata janë arkitektët e qyteteve të së ardhmes ku vlerësohet hapësira si dimension qytetërimi.

## KUR KUJDESI ËSHTË EDHE PASION



**P**rofesori ishte një nga ata personazhe që vlerësohet dhe ka mirënjohjen e të gjithëve.


Ishte farmacist, mjek, i specializuar në rehabilitim, ftiziatr dhe mjekësi sportive, pedagog universiteti dhe mjek sportiv (ndër të tjera, edhe për ekipin e futbollit të Romës për mbi njëzet vjet). Prof. Alicicco njihet si një nga pionierët e fizioterapisë në Shqipëri përmes qendrës sonë të rehabilitimit ku ishte një ekspert i zellshëm dhe promotor i vendosur.

Vitet e fundit e kishte reduktuar shumë praninë e tij në Tiranë, por megjithatë la një kujtim të pashlyeshëm që nuk u shua as me ndarjen e tij nga jeta më datë 17 shtator. Krahas vlerësimit të profesionalizmit të tij nuk harrojmë as simpatinë që ndante gjatë mbrëmjeve në Foresterinë e Universitetit, mes diskutimeve plot gjallëri dhe...shakave të bukura.

Në Shqipëri programi i studimit në Fizioterapi lindi për herë të parë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Gjatë dy dekadave UKZKM solli në Shqipëri profesorë të shkëlqyer me reputacion ndërkombëtar, të cilët edukuan studentët që sot me meritë janë pjesë e shërbimit të vyer në Shqipëri dhe në shumë vende të BE-së, duke u ardhur në ndihmë njerëzve që kanë nevojë. Sot nderojmë kujtimin e **Prof. Ernesto Alicicco**, i cili u nda nga kjo jetë duke lënë pas mirënjohjen e qindra studentëve që sot janë titullarë të shërbimit të Fizioterapisë dhe nderimin e profesorëve të UKZKM që bashkëpunuan me të prej shumë vitesh.



**Prof. Alicicco** nuk ishte thjesht profesori i studentëve, por ai ishte mentori dhe mbështetësi më i madh i të rinjve që sot mbajnë tituj shkencorë në fushën e shërbimit të Fizioterapisë, edhe falë profesionalizmit të lartë edukativ e akademik të tij.



Profesori u nderua gjerësisht edhe në mediat sociale të Italisë, për shkak se ka mbajtur detyrën e mjekut pranë skuadrës së futbollit të Romës, një nga ekipet me histori dhe mbështetje masive të tifozerisë italiane.

# Takimet e **ARDHSHME**



Ju presim  
në stendën tonë  
pranë Maratonës  
së Tiranës

20 Tetor 2024  
Sheshi Skënderbej  
ora 9:00

Roundtable  
**Enlargement: issues  
and perspectives  
in the Western Balkans**

22 Ottobre 2024  
ore 15:00  
Aula BA-105,  
UCNSBC, Tirana



**Tetori rozë.**



UNIVERSITETI KATOLIK  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË



CONFERENCE

**The Elderly Condition  
in the Balkans and  
Eastern Europe:  
Challenges and  
Opportunities**

31 OCTOBER 2024  
09:00 AM

Aula Magna, Catholic University  
"Our Lady of Good Counsel" TIRANA (AL)

The conference is a Continuing Medical Education (CME) event and is in the process of accreditation in Italy by AGENAS (National Agency for Regional Health Services), Provider no 6780 Nautilus Global Academy, and in Albania by ASCK (Health and Social Care Quality Assurance Agency).

Sesioni i diplomimi  
në **Ekonomi Ndërmarrjeje**

24 Tetor 2024 09:00 Aula Magna

Sesioni i diplomimi  
në **Mjekësi**

28 Tetor 2024 09:30 Aula Magna

Sesioni i diplomimi  
në **Stomatologji**

29 Tetor 2024 09:30 Aula Magna



www.unizkm.al

With the graphic support of



With the unconditional support of

